



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, mori këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË SENATORIT ROBERT DOLL

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e bustit të senatorit Robert Doll, në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e bustit të senatorit Robert Doll, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 7232-0, ZK Prishtinë, në pronësi: pronë shoqërore – P.sh. Industria e Tekstilit Napredak.
- III. Ky vendim paraqet bazë për caktimin e lokacionit të kësaj shtatoreje.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-239139/19, më 30.09.2019

KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta



A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të senatorit Robert Doll

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës drejtuar Kryetarit të Komunës, për vendosjen e bustit të senatorit Robert Doll.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më. 19.07.2019, ka miratuar Vendimin për ngritjen e bustit të senatorit Robert Doll, në rrugën "Robert Doll" në Prishtinë, në shenjë respekti ndaj kontributit të senatorit Doll dhe raportit të fuqishëm ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës. Ngritjen e bustit do ta bashkëfinancojë edhe Oda Ekonomike Amerikane.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e bustit, i cili gjendet në kuadër të Planit rregullues urban "Lakërishta", sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për hapësirë me përmbajtje publike.

Lokacioni i propozuar shtrihet në parcelën kadastrale nr. 7232-0, ZK Prishtinë, në pronësi, pronë shoqërore – P.sh. Industria e Tekstilit Napredak.

Vendosja e bustit në fjalë në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së parashtruar.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset busti është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes së tij duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit. Propozohet të vendoset në madhësinë, formën dhe materialin e përcaktuar sipas kërkesës së parashtruar.

Bashkëngjitur:

Ortofoto e lokacionit.

Ortofoto e lokacionit

